

Fejton: “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” (14)

Tradhtia ndërkombëtare e Bosnjës unike

Komuniteti ndërkombëtar, duke theksuar mospajtimin e serbëve, tash u zmbraps nga besimi i mëparshëm se Bosnja mund të jetë një vend i bashkuar. Në një takim të mbajtur në Lisbonë dy javë pas deklarimit të pavarësisë boshnjake, BE-ja ndërmjetësoi një marrëveshje që do ta ndante vendin në dhjetë kantone të përcaktuara etnikisht

Përkundër ndruajtjeve të mëdha rreth mbajtjes së referendumit, Alija Izetbegović u pajtua që ta bëjë këtë. Votimi, i bërë më 28 shkurt dhe 1 mars 1992, shënoi dalje të madhe prej 63.4 për qind të votuesve me të drejtë vote, prej të cilëve pothuaj qind për qind votuan në favor të pavarësisë. Kjo do të thotë se një shumicë absolute e qytetarëve të Bosnjë-Hercegovinës votuan për pavarësinë e shtetit. Për fat të keq, shumica dërrmuese e atyre që votuan ishin boshnjakë dhe kroatë. Sikur që ka qenë shumë lehtë të parashihet, shumica e serbëve, që përbënin rreth një të tretën e popullatës së tërë Bosnjës, e bojkotuan referendumin. Sidoqoftë, vetëm dy ditë më vonë, Izetbegović shpalli pavarësinë e Bosnjë-Hercegovinës. Komuniteti ndërkombëtar, duke theksuar mospajtimin e serbëve, tash u zmbraps nga besimi i mëparshëm

se Bosnja mund të jetë një vend i bashkuar. Në një takim të mbajtur në Lisbonë dy javë pas deklarimit të pavarësisë boshnjake, BE-ja ndërmjetësoi një marrëveshje që do ta ndante vendin në dhjetë kantone të përcaktuara etnikisht.

Serbët dhe kroatët e pranuan këtë ide, por Izetbegović jo, duke u frikësuar se msylimanët e Bosnjës do të lihen si një pre e lehtë për fqinjët më të fuqishëm serbë dhe kroatë.

Qysh në fillim të prillit “spastrimi” i Luginës së Drinës ishte duke u bërë, dhe brenda disa javëve forcat serbe pushtuan rreth 60 për qind të vendit.

Pothuaj të gjithë vëzhguesit ndërkombëtarë pajtohen se bashkësia ndërkombëtare e ka trajtuar shpërbërjen e Jugosllavisë shumë keq.

John Gillingham, për shembull, e ka quajtur atë “një fiasko diplo-

matike në vrapim”.

Evropianët kishin probleme të merren me situatën, së pari sepse ata ishin të ndarë mes vete jo vetëm në aftësinë për të koordinuar politikën e tyre të jashtme kombëtare, por edhe në bllokimin dhe nganjëherë konfliktin mes organizatave ndërkombëtare që u përtfshinë në krizë. Shtetet e Bashkuara, NATO-ja, Kombet e Bashkuara, OSBE-ja, Bashkimi Evropian dhe shumë OJQ - të gjitha luajtën rolet e veta, por jo gjithmonë në mënyrë të koordinuar.

Komisioni i Badinterit, që përbëhej nga ekspertë kushtetutes, puna e të cilëve ishte që të trajtonjë çështjet ligjore dhe teknike në një situatë të dhunshme dhe me zhvillime të shpejta, siguruan arsyeshmërinë që përkrahte një de facto politikë të pranimit të shpërbërjes së Jugosllavisë, dhe posaçërisht duke pranuar të



Në tetor 1991, kur forcat serbe dhe malazeze nisën bombardimin e Dubrovnikut, një sulm nga forcat ajrore të NATO-s kundër pozitave të artilerisë serbe dhe një flotë përkrahëse në Adriatik ka mundur të dërgojë një mesazh të qartë se agresioni do të përballët me forcë

drejtën e serbëve në Bosnjë që të definojnë veten si popull konstitutiv dhe jo si minoritet. Perëndimi po ashtu ishte i pavullnetshëm që të përdorë forcën që ka mundur të jetë efektive. Në tetor 1991, kur forcat serbe dhe malazeze nisën bombardimin e Dubrovnikut, një sulm nga forcat ajrore të NATO-s kundër pozitave të artilerisë serbe dhe një flotë përkrahëse në Adriatik ka mundur të dërgojë një mesazh të qartë se agresioni do të përballët me forcë.

Dështimi për të bërë këtë vetëm sa e konfirmoi konkludimin që tashmë e kishin ushtria serbe, në bazë të studimit që i bënë luftës së arë të gjirit, se intervenimi i hapur Perëndimor, posaçërisht amerikan dhe i NATO-s, në Jugosllavi ishte tejet i pabesueshëm.

(Nesër: Çka ndodhi kur Perëndimi vendosi të intervenojë? Pse as intervenimi ndërkombëtar nuk e parandaloi agresionin?)

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (16)

Gjurmët e taksave të papaguara

“Gomarët që punojnë në shërbimin e grumbullimit të tatimit nuk dinë ta bëjnë punën e tyre”, kishte thënë pa të keq punëtori i Capones. “Për pesë vjet i kanë kontrolluar librat e kontabilitetit të Capones dhe nuk kanë ditur t’i gjejnë dallaveret. E, sa lehtë kanë mundur ta burgosnin”

Agjentët De Angelo dhe Graziano ishin infiltruar në radhët e bandës së Al Capones dhe tashmë ia kishin dhënë shtetit shumë informacione të rëndësishme për të. Megjithatë, asnjëra nga këto informacione nuk ishte aq e rëndësishme sa të mund ta fuste në burg Caponen për një kohë më të gjatë. Derisa Capone po e vazhdonte punën e tij, detektivi Eliot Ness dhe bashkëpunëtorët e tij po vëzhgonin me durim.

Një ditë prej ditësh, ndodhi ajo që e kishin pritur prej shumë kohësh. Agjentët e infiltruar nisën të merrnin infoiracione të rëndësishme. Agjenti Graziano ishte ulur në një kafene dhe po bisedonte me njëri nga punëtorët e Capones.

“Gomarët që punojnë në shërbimin e grumbullimit të tatimit nuk dinë ta bëjnë punën e tyre”, kishte thënë pa të keq punëtori i Capones. “Për pesë vjet i kanë kontrolluar librat e kontabilitetit të Capones dhe nuk kanë ditur t’i gjejnë dallaveret. E, sa lehtë kanë mundur ta burgosnin”.

Fjala kishte qenë për disa shënime të

shmangies së tatimit të viteve 1924-1926. Detektivët nisën të kërkonin kush kishte qenë kontabilist i Capones në atë kohë. Nuk mund t’i binin në fije. Agjenti Graziano duhej të rrezikonte sërish dhe të bisedonte me punëtorin e Capones.

“Kush kanë qenë kontabilistët e Capones në atë kohë?” - kishte pyetur ai, gjoja sa për të bërë muhabet.

“Kanë qenë një dy shula që janë larguar nga Chicago pesë vjet më parë”, kishte thënë punëtori që nuk po dysonte fare në hilenë e Grazianos. Për Eliot Nessin kjo bisedë ishte e mjaftueshme për t’i mësuar emrat e dy kontabilistëve. Ata ishin Leslie Shumway dhe Fred Reis.

Derisa Nessi dhe detektivët e tij po e kapnin fillin, Al Capone po punonte për ta kthyer reputacionin e nëpërkëmbur. Ishte fundi i vitit 1930 dhe Amerika kishte rënë në një krizë të rëndë ekonomike të njohur si koha e “Depresionit”. Al Capone vendosi të bëhej sërish njeri i popullit dhe e hapi një kuzhinë, ku shërbente supë falas për të gjithë qytetarët e uritur.

Qytetarët e uritur po ngroheshin me supat e Capones edhe në fillim të vitit 1931. Në atë kohë, ish-kontabilisti i tij Leslie Shumway po ngrohej në Miami, kur në derë i trokitën detektivët e Eliot Nessit.

Pak ditë më vonë, të njëjtët detektivë trokitën edhe në dyert e Fred Reisit në Preoria të Illinoisit.

Të dy ish-kontabilistët e Capones pranuan që të bashkëpunojnë me policinë.

Eliot Nessi u ofroi mbrojtje maksimale dhe ata e ndienin veten të sigurt nga sulmet eventuale të njerëzve të Al Capones.

(Në numrin e ardhshëm: Si e quante Eliot Nessi Al Caponen? Çka bisedonin këta dy në telefon? Pse nervozohet Capone? Cili është dëmi i madh që iu shkaktua kumbarës së nëntokës?)



**Gangsterë të tjerë të shquar
Bugsy Siegel**

Emri i tij i vërtetë ishte Benjamin Hymen Siegel, por njihej edhe me nofkën Bugsy. Kjo nofkë nuk i pëlqente dhe ashtu e quanin vetëm prapa shpinës. Ishte mik i dy mafiozëve të shquar Lucky Luciano dhe Meyer Lensky. Bugsy Siegel e kishte një ëndërr: të ndërtonte hotele e kasino në shkretëtirë. Kështu ai e krijoi kasino-hotelin e parë të quajtur “Flamengo” në qytezën e quajtur Las Vegas në shtetin e Nevadës. Më pas qyteza do të bëhej qyteti më i njohur në botë për kazino dhe bixhoz. Megjithatë, vetë Siegel kishte marrë borxhe të shumta nga mafia për kazinon e tij dhe në fund nuk kishte arritur t’i paguante ato borxhe. Lucky Luciano e mbronte dhe e pengonte vrasjen e tij. Mirëpo, kur e dashura e Bugsyt, Virginia Hill, ia vodhi paratë dhe iku në Paris, Bugsy ishte në hall. As Lucky Luciano nuk mund ta mbronte më. E vranë në shtëpinë e tij më 1946, derisa po lexonte. Një film për të është xhiruar më 1991 (“Bugsy”) me Warren Bety në rolin kryesor. Po ashtu, personazhi Mo Green në filmin “Kumbara” është në të vërtetë personifikim i Bugsy Siegelit.

